


Tregtia e jashtme e mallrave

Shkurt 2023

Tiranë, më 17 Mars 2023: Në Shkurt 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 38 mld lekë, duke u rritur me 2,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me -8,9 %, në krahasim me Janar 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 69 mld lekë, duke u rritur me 1,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 19,4 %, në krahasim me Janar 2023. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 31 mld lekë, duke u ulur me -0,8 %, krahasuar me Shkurt 2022 dhe duke u rritur me 93,2 %, në krahasim me Janar 2023.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dymujor eksportet e mallrave arritën vlerën 80 mld lekë, duke u rritur me 11,2 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 128 mld lekë, duke u rritur me 3,2 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 47 mld lekë, duke u ulur me 8,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shkurt 2023, në rritjen e eksporteve prej 2,8 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,6 pikë përqindje, Ushqime, pije, duhan” me +2,0 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje. Ndërsa grupet: që kanë pasur ulje janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,9 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -1,0 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2023




Eksportet, gjatë këtij dymujori janë rritur me 11,2 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +5,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me 2,4 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,1 pikë përqindje. Grupi që kanë pasur ulje vjetore të eksporteve, është: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,9 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Shkurt 2023, në rritjen e importeve prej 1,1 %, krahasuar me Shkurt 2022, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +5,4 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,8 pikë përqindje. Ndërsa grupet: që kanë pasur ulje janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,0 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me -1,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2023



Si dymujor, importet janë rritur me 3,2 %, krahasuar me dymujorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,9 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,4 pikë përqindje dhe “ Tekstile dhe këpucë” me +0,4 pikë përqindje. Grupet që kanë pasur ulje vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,5 pikë.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shkurt 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2022 janë: Greqia (92,6 %), Spanja (640,3 %) dhe Austria (34,6 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (1,2 %), Kosova (20,4 %) dhe Gjermania (30,9 %).

Gjatë këtij dymujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Greqia (87,1 %), Kosova (2,8 %) dhe Maqedonia e Veriut (61,2 %). Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Italia (2,6 %), Gjermania (23,8 %) dhe Kina (27,3 %).

Në muajin Shkurt 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Italia (0,9 %), Kina (63,5 %) dhe Gjermania (8,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me Shkurt 2022 janë: Turqia (0,9 %), Greqia (19,7 %) dhe Maqedonia e Veriut (10,9 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Gjermania (11,4 %), Kina (46,2 %) dhe SHBA (50,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (5,0 %), Turqia (2,6 %) dhe Greqia (14,3 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2023



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,5 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,6 %), Kina (8,1 %), Turqia (7,5 %) dhe Greqia (7,2 %).

Shkëmbimet tregtare, për dymujorin e parë 2023, me vendet e BE-së zënë 59,4 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,6 %), Turqia (7,4 %), Kina (7,3 %) dhe Greqia (7,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Shkurt 2023

| Vitet | Muajt | Eksporte (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Importe (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Bilanci Tregtar (mld lekë) | Mbulimi (%) |
|-------|-------------------|------------------------|-------------------------|-----------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------|
| 2000 | | 37 | -23,5 | 157 | -1,5 | -120 | 23,6 |
| 2001 | | 44 | 19,1 | 190 | 21,0 | -146 | 23,2 |
| 2002 | | 47 | 7,7 | 210 | 10,6 | -163 | 22,6 |
| 2003 | | 54 | 14,7 | 226 | 7,4 | -172 | 24,1 |
| 2004 | | 62 | 14,0 | 236 | 4,5 | -174 | 26,3 |
| 2005 | | 66 | 6,0 | 262 | 11,1 | -196 | 25,1 |
| 2006 | | 77 | 17,6 | 299 | 14,1 | -222 | 25,9 |
| 2007 | | 97 | 25,5 | 376 | 25,8 | -279 | 25,8 |
| 2008 | | 113 | 15,8 | 440 | 16,9 | -327 | 25,6 |
| 2009 | | 105 | -7,2 | 429 | -2,5 | -324 | 24,4 |
| 2010 | | 162 | 54,6 | 478 | 11,4 | -316 | 33,8 |
| 2011 | | 197 | 21,9 | 544 | 13,9 | -347 | 36,2 |
| 2012 | | 213 | 8,2 | 528 | -2,9 | -315 | 40,3 |
| 2013 | | 246 | 15,7 | 517 | -2,1 | -271 | 47,6 |
| 2014 | | 256 | 3,8 | 552 | 6,7 | -296 | 46,3 |
| 2015 | | 243 | -4,9 | 545 | -1,4 | -302 | 44,7 |
| 2016 | | 243 | 0,1 | 579 | 6,4 | -336 | 42,0 |
| 2017 | | 273 | 12,1 | 626 | 8,1 | -353 | 43,6 |
| 2018 | | 310 | 13,7 | 641 | 2,4 | -331 | 48,4 |
| 2019 | | 299 | -3,8 | 649 | 1,2 | -350 | 46,0 |
| 2020 | | 272 | -9,0 | 605 | -6,8 | -333 | 44,9 |
| 2021 | | 369 | 35,6 | 801 | 32,3 | -432 | 46,1 |
| 2022 | | 487 | 32,0 | 950 | 18,7 | -464 | 51,2 |
| 2020 | 01 - 20 | 23 | 5,3 | 42 | -0,4 | -19 | 54,9 |
| | 02 - 20 | 25 | 10,6 | 52 | 3,9 | -27 | 48,3 |
| | Janar– Shkurt 20 | 48 | 72,6 | 94 | 67,1 | -46 | 51,3 |
| 2021 | 01 - 21 | 24 | 3,1 | 45 | 8,4 | -22 | 52,3 |
| | 02 - 21 | 25 | -0,9 | 52 | 0,9 | -27 | 47,4 |
| | Janar – Shkurt 21 | 49 | 1,0 | 98 | 4,3 | -49 | 49,7 |
| 2022 | 01 - 22 | 35 | 47,5 | 55 | 21,1 | -20 | 63,6 |
| | 02 - 22 | 37 | 50,5 | 69 | 31,5 | -31 | 54,3 |
| | Janar– Shkurt 22 | 72 | 49,0 | 124 | 26,7 | -51 | 58,4 |
| 2023 | 01 - 23 | 42 | 20,2 | 58 | 5,8 | -16 | 72,3 |
| | 02 - 23 | 38 | 2,8 | 69 | 1,1 | -31 | 55,2 |
| | Janar– Shkurt 23 | 80 | 11,2 | 128 | 3,2 | -47 | 63,0 |

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Shkurt 2023

| | Eksporte | | | | Importe | | | |
|-----------------------|---------------|---------------|--------------------|--------------------|---------------|---------------|--------------------|--------------------|
| | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Jan, - Shkurt 2022 | Jan, - Shkurt 2023 | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Jan, - Shkurt 2022 | Jan, - Shkurt 2023 |
| Vendet e BE-së | 27.010 | 29.483 | 53.405 | 58.452 | 37.517 | 36.780 | 66.365 | 65.250 |
| Austri | 402 | 542 | 697 | 756 | 603 | 556 | 1.065 | 968 |
| Gjermani | 3.161 | 2.183 | 6.885 | 5.247 | 4.685 | 5.066 | 7.984 | 8.897 |
| Greqi | 1.847 | 3.556 | 3.691 | 6.905 | 5.299 | 4.256 | 9.268 | 7.943 |
| Itali | 17.548 | 17.339 | 33.973 | 33.087 | 16.590 | 16.743 | 30.099 | 28.593 |
| Spanjë | 150 | 1.110 | 940 | 3.227 | 1.291 | 984 | 1.952 | 1.947 |
| Kroaci | 719 | 638 | 1.025 | 1.014 | 482 | 523 | 823 | 986 |
| Të tjera të BE-së | 3.183 | 4.115 | 6.193 | 8.215 | 8.568 | 8.653 | 15.174 | 15.914 |
| Mbretëri e Bashkuar | 96 | 149 | 202 | 326 | 644 | 868 | 1.017 | 1.336 |
| Kinë | 1.068 | 754 | 1.806 | 1.313 | 4.911 | 8.032 | 9.466 | 13.836 |
| Kosovë | 3.380 | 2.690 | 6.120 | 6.292 | 1.437 | 766 | 1.957 | 1.812 |
| Maqedonia e Veriut | 2.236 | 1.490 | 3.680 | 5.932 | 1.266 | 1.128 | 1.868 | 1.947 |
| Rusi | - | - | 2 | 3 | 1.714 | 492 | 2.251 | 943 |
| SHBA | 374 | 423 | 814 | 906 | 911 | 1.245 | 1.702 | 2.568 |
| Turqi | 263 | 325 | 635 | 895 | 7.805 | 7.734 | 14.787 | 14.406 |
| Ukrainë | 56 | 206 | 80 | 342 | 329 | 191 | 1.258 | 537 |
| Zvicër | 510 | 545 | 623 | 1.611 | 739 | 663 | 1.414 | 1.205 |
| Të tjera | 2.297 | 2.271 | 4.929 | 4.342 | 11.425 | 11.583 | 21.627 | 23.843 |
| Gjithsej | 37.289 | 38.336 | 72.295 | 80.414 | 68.697 | 69.482 | 123.712 | 127.680 |

Tab.3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Shkurt 2023

| Grup-mallrat | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---------------------------------|---------------|---------------|--------------------|--------------------|---------------|---------------|--------------------|--------------------|
| | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Jan, - Shkurt 2022 | Jan, - Shkurt 2023 | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Jan, - Shkurt 2022 | Jan, - Shkurt 2023 |
| Gjithsej | 37.289 | 38.336 | 72.295 | 80.414 | 68.697 | 69.482 | 123.712 | 127.680 |
| Ushqime, pije, duhan | 2.982 | 3.737 | 6.314 | 7.315 | 10.931 | 10.170 | 20.014 | 19.961 |
| Minerale, lëndë djegëse, en,el, | 9.660 | 8.960 | 19.028 | 22.830 | 9.857 | 7.266 | 18.074 | 15.372 |
| Produkte kimike dhe plastike | 1.510 | 1.133 | 2.790 | 2.145 | 9.188 | 9.895 | 15.327 | 17.049 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 266 | 307 | 473 | 569 | 1.479 | 1.308 | 2.529 | 2.260 |
| Prodhime druri dhe letre | 1.114 | 990 | 1.982 | 1.985 | 2.375 | 2.602 | 4.715 | 4.367 |
| Tekstile dhe këpucë | 10.644 | 11.094 | 20.703 | 22.449 | 7.425 | 8.007 | 13.932 | 14.401 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 7.487 | 7.428 | 14.056 | 14.498 | 10.849 | 9.507 | 20.443 | 18.576 |
| Makineri, pajisje dhe pj, këmb, | 2.758 | 3.740 | 5.348 | 6.876 | 13.999 | 17.741 | 24.331 | 30.336 |
| Të tjera | 867 | 946 | 1.599 | 1.747 | 2.595 | 2.987 | 4.346 | 5.358 |

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2023

| | Itali | | Greqi | | Kosova | | Maqedonia | |
|--|---------------|---------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| | 2022 | 2023 | 2022 | 2023 | 2022 | 2023 | 2022 | 2023 |
| Gjithsej | 33.973 | 33.087 | 3.691 | 6.905 | 6.120 | 6.292 | 3.680 | 5.932 |
| Ushqim, pije duhan | 1.799 | 2.304 | 607 | 725 | 576 | 756 | 170 | 232 |
| Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike | 4.658 | 1.380 | 852 | 3.821 | 1667 | 1.820 | 2.030 | 4.168 |
| Produkte kimike dhe plastike | 662 | 1.021 | 136 | 157 | 723 | 461 | 46 | 42 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 447 | 543 | 3 | 8 | 3 | 1 | 0 | |
| Prodhime druri dhe letre | 1.133 | 1.241 | 296 | 286 | 285 | 167 | 57 | 61 |
| Tekstile dhe këpucë | 16.115 | 17.650 | 908 | 1.055 | 22 | 27 | 13 | 10 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 5.510 | 4.665 | 785 | 725 | 2421 | 2.582 | 1.283 | 1.363 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 2.807 | 3.392 | 15 | 8 | 236 | 259 | 52 | 25 |
| Të tjera | 841 | 890 | 88 | 119 | 188 | 219 | 30 | 31 |

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shkurt 2023

| | Itali | | Turqi | | Kinë | | Gjermani | |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|---------------|--------------|--------------|
| | 2022 | 2023 | 2022 | 2023 | 2022 | 2023 | 2022 | 2023 |
| Gjithsej | 30.099 | 28.593 | 14.787 | 14.406 | 9.466 | 13.836 | 7.984 | 8.897 |
| Ushqim, pije duhan | 3.973 | 3.936 | 842 | 826 | 212.5 | 257 | 822 | 872 |
| Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike | 1.938 | 619 | 499 | 2.376 | 0.9 | 5 | 224 | 120 |
| Produkte kimike dhe plastike | 3.359 | 3.423 | 1.593 | 1.951 | 920.9 | 1.210 | 1.825 | 1.735 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 2.092 | 1.800 | 79 | 55 | 102.3 | 121 | 20 | 9 |
| Prodhime druri dhe letre | 1.005 | 1.031 | 733 | 987 | 132.2 | 244 | 178 | 111 |
| Tekstile dhe këpucë | 7.027 | 6.887 | 2.594 | 2.132 | 1538.8 | 1.854 | 388 | 361 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 3.875 | 4.047 | 6.296 | 3.619 | 870.2 | 1.935 | 247 | 374 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 5.852 | 5.723 | 1.468 | 1.790 | 4863.7 | 7.200 | 4.001 | 4.947 |
| Të tjera | 977 | 1.127 | 685 | 669 | 824.4 | 1.010 | 279 | 368 |

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci,

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri